

VENDIM
Nr. 447, datë 31.7.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 428, DATË 26.6.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E TARIFAVE DHE TË MËNYRËS SË PËRDORIMIT TË TYRE PËR SHËRBIMET QË KRYHEN NGA SEKRETARIATI TEKNIK I KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT DHE UJIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 46/1, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në kreun I, “Shërbimet dhe tarifat”, të vendimit nr. 428, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave dhe të mënyrës së përdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 3, pas shkronjës “ë” shtohet shkronja “P”, me këtë përmbajtje:

“f) ndryshimi/rishikimi i lejes së zhvillimit.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Tarifa për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimi dhe tarifa për shqyrtimin e kërkesave për ndryshimin/rishikimin e lejeve të zhvillimit do të llogaritet në bazë të sipërfaqes bazë së pronave që do të zhvillohen dhe niveli i tarifës do të llogaritet:

a) për projektet me sipërfaqe të përgjithshme prone deri në 100 ha, tarifa është në vlerën 100 (njëqind) lekë për m²;

b) për projektet me sipërfaqe të përgjithshme prone mbi 100 ha, tarifa është në vlerën 100 (njëqind) lekë për m², por jo më shumë se 130 000 000 (njëqind e tridhjetë milionë) lekë në total.”.

3. Pas pikës 4 shtohen pikat 4/1 dhe 4/2, me këtë përmbajtje:

“4/1. Nga përcaktimet e bëra në pikën 4, përjashtohen aplikimet për leje zhvillimi për centralet gjeneruese të energjisë, tarifa për shqyrtimin e të cilave do të llogaritet sipas përcaktimeve, si më poshtë vijon:

a) Për centralet deri në 2 *mw*, tarifa fikse në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë;

b) Për centralet mbi 2 *mw* deri në 10 *mw*, tarifa fikse në vlerën 3 000 000 (tre milionë) lekë;

c) Për centralet mbi 10 *mw* deri në 50 *mw*, tarifa fikse në vlerën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

ç) Për centralet mbi 50 *mw* deri në 100 *mw*, tarifa fikse në vlerën 20 000 000 (njëzet milionë) lekë;

d) Për centralet mbi 100 *mw*, tarifa fikse në vlerën 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë.

4/2. Paga e tarifës për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimi dhe tarifa për shqyrtimin e kërkesave për ndryshimin/rishikimin e lejeve të zhvillimit, sipas parashikimeve të pikës 4, të këtij kreu, kryhet pas konfirmimit të vendimit të miratimit të lejes së zhvillimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës nga AZHT-ja.”.

4. Pikat 5 dhe 6 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“5. Tarifa për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi është në vlerën 1% të vlerës së investimit të deklaruar në sistemin e-Leje. Vlera e investimit llogaritet sipas preventivit të investimit, të hartuar dhe të deklaruar nga inxhinieri preventivues, sipas legjislacionit në fuqi. Preventivi i investimit dhe deklarata e inxhinierit preventivues, me anë të së cilës deklarohet nën përgjegjësinë e tij të plotë civile dhe penale se preventivi është hartuar në përputhje me rregullat dhe manualin në fuqi, ngarkohen nga kërkuuesi në sistemin e-Leje. Paga kryhet pas konfirmimit të vendimit të miratimit të lejes së ndërtimit

nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës së arkëtimit nga AZHT-ja.

6. Tarifa për shqyrtimin e kërkesave për ndryshimin e subjektit zhvillues është në vlerën 1% të vlerës së investimit të deklaruar në sistemin e-Leje. Vlera e investimit llogaritet sipas preventivit të investimit, të hartuar dhe të deklaruar nga inxhinieri preventivues, sipas legjislacionit në fuqi. Preventivi i investimit dhe deklarata e inxhinierit preventivues, me anë të së cilës deklarohet nën përgjegjësinë e tij të plotë civile dhe penale se preventivi është hartuar në përputhje me rregullat dhe manualët në fuqi, ngarkohen nga kërkuesi në sistemin e-Leje. Pagesa kryhet pas konfirmimit të vendimit të miratimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës nga AZHT-ja.”.

5. Në pikën 8, fjalët “..., si dhe për lëshimin e certifikatave të përdorimit ...” dhe fjalia e fundit hiqen.

6. Pas pikës 8 shtohet pika 8/1, me këtë përmbajtje:

“8/1. Tarifa për shqyrtimin e kërkesave për lëshimin e certifikatave të përdorimit është në vlerën 1% e diferencës midis vlerës së situacionit përfundimtar të punimeve me preventivin fillestar të investimit, të deklaruar në sistemin e-Leje në momentin e marrjes së lejes së ndërtimit. Pagesa për lëshimin e certifikatave të përdorimit kryhet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës nga AZHT-ja.”.

7. Në pikën 11, pas fjalëve “... apo të objekteve publike ...” shtohen “... si dhe objektet me destinacion publik që ndërtohen në bazë të partneriteteve publike private ...”.

II. Dispozitë kalimtare

Agjencia e Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, merr të gjitha masat, që, brenda muajit mars 2026, të kryhet lëshimi i faturave brenda sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit. Deri në krijimin e modaliteteve përkatëse, brenda sistemit e-Leje, AZHT-ja mund të kryejë lëshimin e faturave dhe autorizimeve për kryerjen e pagesave, sipas tarifave të përcaktuara në këtë vendim, jashtë sistemit e-Leje.

III. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku